



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2023-10

**Prokurorja e Specializuar k. Sabit Januzit, Ismet Bahtijarit dhe
Haxhi Shalës**

Vendosi: Gjykatësi i Procedurës Paraprake

Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Data: 27 mars 2024

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

**Vendim që Përcakton Kalendarin për Hapat e Mbetur Proceduralë të Fazës së
Procedurës Paraprake**

Prokurores së Specializuar
Kimbërli P. Uest

Mbrojtjes së Sabit Januzit
Xhonatan Elistan Ris
Hju Bauden

Zyrës Administrative
Fidelma Donlon

Mbrojtjes së Ismet Bahtijarit
Dr. Felisiti Geri
Xhejms O’Kif

Mbrojtjes së Haxhi Shalës
Tobi Kadman
Xhon Kubon
Almudena Bernabeu Garcia

GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE,¹ në bazë të neneve 21(4)(d) dhe (e), 34(7) dhe 39(1), (3) dhe (13) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe rregullave 72 dhe 95(2) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja"), lëshon vendimin e mëposhtëm.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 4 tetor 2023, Zyra e Prokurorit të Specializuar ("ZPS") dorëzoi aktakuzën kundër Sabit Januzit ("z. Januzi") dhe Ismet Bahtijarit ("z. Bahtijari"),² konfirmuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake më 2 tetor 2023.³
2. Më 5 tetor 2023, z. Bahtijari dhe z. Januzi⁴ u arrestuan dhe u transferuan të nesërmen në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara ("DHS").⁵

¹ KSC-BC-2023-10, F00001, Kryetarja, *Vendim për Caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 11 shtator 2023, publik; KSC-BC-2023-11, F00001, Kryetarja, *Vendim për Caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 20 nëntor 2023, publik.

² KSC-BC-2023-10, F00010, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i Aktakuzës së Konfirmuar*, 4 tetor 2023, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, me Shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale. Versioni i redaktuar publik i parashtrimit dhe shtojcës u dorëzuan më 6 tetor 2023, F00016 dhe F00016/A01.

³ KSC-BC-2023-10, F00008, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Konfirmimin e Aktakuzës*, 2 tetor 2023, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*. Versioni i redaktuar konfidencial dhe versioni i redaktuar publik i vendimit u dorëzuan më 12 tetor 2023, F00008/CONF/RED dhe F00008/RED. Versioni i korrigjuar i versionit të redaktuar publik të vendimit u dorëzua më 12 tetor 2023, F00008/RED/COR.

⁴ KSC-BC-2023-10, F00011, Administratorja, *Njoftim i Arrestimit të Ismet Bahtijarit sipas Rregullës 55(4)*, 5 tetor 2023, publik; F00012, Administratorja, *Njoftim i Arrestimit të Sabit Januzit sipas Rregullës 55(4)*, 5 tetor 2023, publik.

⁵ KSC-BC-2023-10, F00014, Administratorja, *Njoftim i Pranimi të Ismet Bahtijarit në Objektin e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara*, 6 tetor 2023, publik, me Shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*; F00015, Administratorja, *Njoftim i Pranimi të Sabit Januzit në Objektin e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara*, 6 tetor 2023, publik, me Shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

3. Më 6 dhjetor 2023, ZPS-ja dorëzoi aktakuzën kundër Haxhi Shalës ("z. Shala") në çështjen gjyqësore KSC-BC-2023-11 ("Çështja 11"),⁶ konfirmuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake më 4 dhjetor 2024.⁷
4. Më 11 dhjetor 2023, z. Shala⁸ u arrestua dhe u transferua të nesërmen në objektin e paraburgimit të DHS-së.⁹
5. Më 13 dhjetor 2023, ZPS-ja dorëzoi kërkesë për bashkimin e çështjes gjyqësore kundër z. Januzi dhe z. Bahtijari ("Çështja 10") me çështjen gjyqësore kundër z. Shala (Çështja 11).¹⁰ Më 8 shkurt 2024, Gjykatësi i Procedurës Paraprake e miratoi kërkesën.¹¹
6. Më 16 shkurt 2024, ZPS-ja dorëzoi aktakuzën e ndryshuar kundër z. Januzi dhe z. Bahtijari.¹² Më të njëjtën ditë, ZPS-ja dorëzoi Dosjen Paraprake dhe materialet shoqëruese.¹³

⁶ KSC-BC-2023-11, F00007, Prokurorja e Specializuar, *Parashtrim i Aktakuzës së Konfirmuar*, 6 dhjetor 2023, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, me Shtojcën 1, konfidenciale. Versionet e redaktuara publike të parashtrimit dhe të shtojcës u dorëzuan me 12 dhjetor 2023, F00013 dhe F00013/A01.

⁷ KSC-BC-2023-11, F00005, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim për Konfirmimin e Aktakuzës*, 4 dhjetor 2023, konfidencial. Versioni i redaktuar publik i vendimit u dorëzua më 30 janar 2024, F00005/RED.

⁸ KSC-BC-2023-11, F00008, Administratorja, *Njoftim i Arrestimit të Haxhi Shalës sipas Rregullës 55(4)*, 11 dhjetor 2023, publik.

⁹ KSC-BC-2023-11, F00011, Administratorja, *Njoftim i Pranimit të Haxhi Shalës në Objektin e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara*, 12 dhjetor 2023, publik, me Shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

¹⁰ KSC-BC-2023-10, F00132, Prokurorja e Specializuar, *Kërkesë e Prokurorisë për Bashkimin e Çështjeve Gjyqësore*, 13 dhjetor 2023, publike; KSC-BC-2023-11, F00016, Prokurorja e Specializuar, *Kërkesë e Prokurorisë për Bashkimin e Çështjeve Gjyqësore*, 13 dhjetor 2023, publike.

¹¹ KSC-BC-2023-10, F00161, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën për Bashkimin e Çështjeve Gjyqësore dhe Ndryshimin e Aktakuzës*, 8 shkurt 2024, konfidencial. Versioni i redaktuar publik i vendimit u dorëzua më të njëjtën ditë, F00161/RED; KSC-BC-2023-11, F00041, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën për Bashkimin e Çështjeve Gjyqësore dhe Ndryshimin e Aktakuzës*, 8 shkurt 2024, konfidencial. Versioni i redaktuar publik i vendimit u dorëzua më të njëjtën ditë, F00041/RED.

¹² KSC-BC-2023-10, F00176, Prokurorja e Specializuar, *Parashtrim i Aktakuzës së Ndryshuar*, 16 shkurt 2024, publik, me Shtojcën 1, konfidenciale, dhe Shtojcën 2, publike.

¹³ KSC-BC-2023-10, F00177, Prokurorja e Specializuar, *Parashtrim prej Prokurorisë i Dosjes Paraprake, Listës së Dëshmitarëve, Listës së Provave Materiale dhe Tabelës sipas Rregullës 109(c)*, 16 shkurt 2024, publik, me Shtojcat 1-4, konfidenciale.

7. Më 13 shkurt 2024 dhe 22 mars 2024, u mbajtën konferenca e katërt dhe e pestë mbi ecurinë e çështjes.¹⁴ Në urdhrat përkatës për caktimin e datave, Gjykatësi i Procedurës Paraprake i urdhëroi ZPS-në dhe Mbrojtjen të dorëzonin parashtrime me shkrim, nëse dëshironin, për hapat dhe afatet e pritshme të fazës paraprake.¹⁵

II. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

8. Sipas nenit 21(4)(d) dhe (e) të Ligjit, i akuzuari ka të drejtë të gjykohet brenda një kohe të arsyeshme dhe t'i caktohet mbrojtës i specializuar, në çdo rast kur kjo kërkohet për interesa të drejtësisë, dhe pa pagesë në rast se ai nuk ka mjete të mjaftueshme për ta paguar.

9. Sipas nenit 39(13) të Ligjit dhe rregullës 95(2) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake siguron që të mos ketë vonesa të papërligjura të procedimit dhe merr të gjitha masat e nevojshme për përgatitjen e shpejtë të çështjes për gjykim.

10. Sipas rregullës 95(2)(a), (b), dhe (j) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake: (i) përcakton kalendarin dhe planin e punës në lidhje me detyrimet e palëve gjatë procedurës paraprake; (ii) përcakton afate për nxjerrjen e materialeve, merr masa për të mundësuar nxjerrjen e materialeve në kohë dhe përgatit një raport për trupin gjykues mbi nxjerrjen e materialeve; dhe (iii) parashikon një datë brenda së cilës çështja duhet të jetë gati për gjykim.

11. Sipas rregullës 95(5) të Rregullores, pas dorëzimit të materialeve sipas rregullës 95(4) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake fton Mbrojtjen që

¹⁴ KSC-BC-2023-10, Transkript i seancës, 13 shkurt 2024, publik; Transkript i seancës ("Transkripti i 22 marsit"), 22 mars 2024, konfidenciale.

¹⁵ KSC-BC-2023-10, F00163, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Urdhër për Caktimin e Datës për Mbajtjen e Konferencës mbi Ecurinë e Çështjes dhe për Paraqitjen e Parashtrimeve*, 8 shkurt 2024, publik; F00213, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Urdhër për Caktimin e Datës për Mbajtjen e Konferencës mbi Ecurinë e Çështjes dhe për Paraqitjen e Parashtrimeve*, 14 mars 2024, publik.

brenda një afati të përcaktuar të dorëzojë dosjen paraprake. Gjithashtu, brenda një afati të përcaktuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake, Mbrojtja informon ZPS-në mbi synimin e vet për të përdorur alibinë ose çfarëdo arsye tjetër që përjashton përgjegjësinë penale.

12. Sipas rregullës 6(1) dhe (2) të Udhëzuesit të Punës të Zyrës Administrative për Rregulloren e Ndihmës Juridike ("Rregullorja e Ndihmës Juridike"),¹⁶ i dyshuari ose i akuzuari që pretendon varfëri të plotë ose të pjesshme dhe që bën kërkesë për ndihmë juridike në përputhje me nenin 34(7) të Ligjit duhet të plotësojë, nënshkruajë dhe t'u dorëzojë: (i) Administratores - kërkesën për caktimin e mbrojtësit; dhe (ii) Zyrës së Mbrojtjes - formularin e kërkesës për ndihmë juridike, së bashku me formularin e deklarimit të mjeteve financiare.

13. Sipas rregullave 7(3) dhe 8 të Rregullores së Ndihmës Juridike, për të përcaktuar varfërinë e plotë ose të pjesshme të të dyshuarit ose të akzuarit, Administratorja kryen vlerësimin e varfërisë.

III. DISKUTIM

A. KËRKESAT PËR NDIHMË JURIDIKE

14. Për garantimin e të drejtave të tre të akzuarve dhe për përgatitjen e shpejtë e të duhur të çështjes para kalimit të saj për gjykim, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mendon se duhet zgjidhur problemi i financimit të ekipeve të Mbrojtjes të z. Januzi, z. Bahtijari dhe z. Shala (bashkërisht, "Mbrojtja" ose "Ekipet e Mbrojtjes"). Gjykatësit të Procedurës Paraprake i janë paraqitur parashtrime të shumta (gojore dhe me shkrim) nga Mbrojtja dhe katër përditësime nga Zyra

¹⁶ KSC-BD-25-Rev1, Administratorja, Udhëzues Pune i Zyrës Administrative - Rregullorja e Ndihmës Juridike, 22 shkurt 2024, publik, me Shtojcat A-C, publike.

Administrative lidhur me aspektin e financimit.¹⁷ Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se dy prej Ekipeve të Mbrojtjes janë pranë dorëzimit ose do t'i dorëzojnë DHS-së kërkesa për ndihmë juridike.¹⁸ Me qëllim që të ketë qartësi dhe për ta zgjidhur këtë aspekt në të mirë të të akuzuarve sa më shpejt që të jetë e mundur, Gjykatësi i Procedurës Paraprake i udhëzon Ekipet e Mbrojtjes që, në rast se (ende) dëshirojnë të kërkojnë ndihmë juridike nga DHS-ja, t'i dorëzojnë formularët e kërkuar dhe çdo material mbështetës në Zyrën Administrative, dhe ta informojnë për këtë Gjykatësin e Procedurës Paraprake deri të premten, 12 prill 2024.

15. Në këtë drejtim, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konfirmon marrjen e kërkesës për financim urgjent nga z. Shala,¹⁹ dhe e udhëzon Mbrojtjen e z. Shala të dorëzojë kërkesën e duhur për ndihmë juridike në pajtim me paragrafin pararendës.

16. Udhëzohen Ekipet e Mbrojtjes që hasin pengesa për plotësimin e formularëve përkatës ose dorëzimin e materialit mbështetës brenda afateve të parashikuara t'i dorëzojnë Gjykatësit të Procedurës Paraprake parashtrime me shkrim pa asnjë vonesë. Në këto parashtrime duhet të tregohen arsyet përse nuk mund të plotësohen formularët në tërësi ose pjesë specifike të tyre. Dorëzimi i shpejtë i formularëve të plotësuar që kërkohen, bashkë me dokumentacionin mbështetës,

¹⁷ KSC-BC-2023-10, F00193, Administratorja, *Përditësim prej Administratores mbi Financimin e Ekipit të Mbrojtjes*, 1 mars 2024, konfidencial, me Shtojcën 1, konfidenciale; F00200, Administratorja, *Përditësim prej Administratores mbi Financimin e Ekipit të Mbrojtjes*, 8 mars 2024, konfidenciale, me Shtojcat 1-4, konfidenciale dhe *ex parte*; F00218, Administratorja, *Përditësim prej Administratores mbi Financimin e Ekipit të Mbrojtjes*, 15 mars 2024, konfidenciale, me Shtojcat 1-6, konfidenciale dhe *ex parte*; F00228, Administratorja, *Përditësim prej Administratores mbi Financimin e Ekipit të Mbrojtjes dhe Parashtrime Shtesë*, 21 mars 2024, konfidenciale, me Shtojcat 1-5, konfidenciale dhe *ex parte*.

¹⁸ Transkripti i 22 marsit, f. 220, rreshtat 12-15, dhe f. 230, rreshtat 17-18.

¹⁹ KSC-BC-2023-10, F00223, Mbrojtja e Haxhi Shalës, *Kërkesë Urgjente e Haxhi Shalës për Financim të Përkohshëm*, 19 mars 2024, konfidenciale.

do t'i mundësojnë Zyrës Administrative t'i shqyrtojë kërkesat për ndihmë juridike në kohën e duhur.

17. Sidoqoftë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake i kërkon Zyrës Administrative t'i shqyrtojë kërkesat për ndihmë juridike urgjentisht.

B. GJENDJA SHËNDETËSORE E TË AKUZUARIT

18. Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton ftesën që i ka bërë Mbrojtjes që, po ta shohë të nevojshme, t'i dorëzojë atij kërkesë me shkrim *ex parte* për vlerësimin mjekësor të të akuzuarit nga një ekspert.²⁰ Në këtë aspekt, Gjykatësi i Procedurës Paraprake e udhëzon Mbrojtjen ta dorëzojë një kërkesë të tillë sa më shpejt që të jetë e mundur, dhe të japë hollësi lidhur me (i) llojin e problemeve shëndetësore me të cilat përballet i akuzuari me qëllim që të identifikohet dhe caktohet eksperti me kualifikime të duhura mjekësore; dhe (ii) llojin e vlerësimit që kërkohet, konkretisht nëse duhet vlerësuar gjendja e të akuzuarit për periudhën pas transferimit të tij në objektin e paraburgimit të DHS-së, për kohën e kryerjes së veprave penale të pretenduara, apo për të dyja.

C. KALENDARI I PROCEDURAVE PARAPRAKE TË MBETURA

19. Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se, në urdhrin për mbajtjen e konferencës mbi ecurinë e çështjes të 22 marsit 2024, njoftoi se, në mungesë të një afati të propozuar për përfundimin e detyrimeve paraprake prej palëve, ai vetë do ta përcaktonte kalendarin për pjesën e mbetur të procedurave paraprake, sipas rregullës 95(2)(a) të Rregullores.²¹

²⁰ Transkripti i 22 marsit, f. 201, rreshti 24, deri në f. 202, rreshti 7.

²¹ KSC-BC-2023-10, F00213, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Urdhër për Caktimin e Datës për Mbjtjen e Konferencës mbi Ecurinë e Çështjes dhe për Paraqitjen e Parashtrimeve*, 14 mars 2024, publik, para. 12.

20. Në këtë aspekt, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vë në dukje se ZPS-ja parashikon t'i përmbushë detyrimet që ka për nxjerrjen e informacionit, si dhe për hetimet që janë në vijimësi e sipër dhe analizimin e çdo materiali provues relevant, deri të premten, 12 prill 2024.²²

21. Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjykon se, pavarësisht se ka kaluar një kohë e gjatë dhe është arritur përparim, mbeten pa u përmbushur një numër detyrimesh dhe aspektesh paraprake. Në këtë drejtim, Gjykatësi i Procedurës Paraprake posaçërisht vë në dukje se:²³

- a) Ekipet e Mbrojtjes pretendojnë se nuk janë në gjendje ta avancojnë dukshëm procesin paraprak për shkak të mungesës së fondeve, dhe ende nuk kanë dorëzuar (apo plotësuar) kërkesat përkatëse për ndihmë juridike nga DHS-ja;
- b) Mbrojtja vazhdon të shprehë shqetësime lidhur me nxjerrjen e materialeve të renditura në njoftimin e ZPS-së sipas rregullës 102(3);
- c) ZPS-ja vazhdon hetimet, dhe planifikon të nxjerrë material tjetër shfajësues relevant;
- d) Mbrojtja ka nisur ose ka hasur pengesa për zhvillimin e hetimeve të veta për arsyet e mëposhtme:
 - Mbrojtja e z. Bahtijari parashtrohet se nuk i ka filluar hetimet e veta për shkak të mungesës së fondeve për ta bërë një gjë të tillë;

²² KSC-BC-2023-10, F00222, Prokurorja e Specializuar, *Parashtrime të Prokurorisë për Konferencën mbi Ecurinë e Çështjes ("Parashtrimet e ZPS-së")*, 19 mars 2024, publike, para. 10; Transkripti i 22 marsit, f. 249, rreshtat 9-18.

²³ *Shih, përgjithësisht*, KSC-BC-2023-10, F00219, Mbrojtja e Ismet Bahtijarit, *Parashtrim i Protokolluar i Bahtijarit për Konferencën mbi Ecurinë e Çështjes*, 18 mars 2024, publik; *Parashtrimet e ZPS-së*; F00224, Mbrojtja e Haxhi Shalës, *Parashtrime të Haxhi Shalës për Konferencën mbi Ecurinë e Çështjes më 22 mars 2024*, 19 mars 2024, publike; F00225, Mbrojtja e Sabit Januzit, *Parashtrime për Konferencën e Pestë mbi Ecurinë e Çështjes*, 19 mars 2024, publike; Transkriptin e 22 marsit 2024.

- Mbrojtja e z. Shala parashtrohet se i ka filluar hetimet e veta, po pretendon se ecuria varet nga garantimi i fondeve nga Ministria e Drejtësisë së Kosovës;
 - Mbrojtja e z. Januzi pretendon se duhet të bëhen hetime, po nuk ka fonde për kryerjen e tyre;
- e) Mbrojtja e z. Shala nuk ka treguar ende nëse do të bëjë kërkesë në lidhje me mundësitë hetimore unike sipas rregullës 99(1) të Rregullores;
- f) Mbrojtja e z. Januzi nuk ka treguar ende nëse do të dorëzojë njoftim për alibi dhe/ose për çfarëdo arsye tjetër që përjashton përgjegjësinë penale;
- g) Mbrojtja e z. Shala dhe Mbrojtja e z. Januzi konfirmojnë synimin për të dorëzuar dosje paraprake në momentin e duhur, po përsërisin se është e pamundur aktualisht të tregojnë se kur do të mund ta bëjnë një gjë të tillë, ndërsa Mbrojtja e z. Bahtijari nuk është në gjendje të tregojë nëse do të dorëzojë dosje paraprake para vlerësimit të aftësisë së tij për t'u gjykuar; dhe
- h) Palët nuk i kanë mbajtur ende diskutimet e tyre *inter partes* për mënyrën më të efektshme të gjetjes së pikave të pajtimit mbi aspekte juridike dhe faktike.

22. Në këto rrethana, dhe duke pasur parasysh faktin se Mbrojtja nuk ka treguar se kur do t'i përmbushë tërësisht detyrimet e veta paraprake, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se është e përshtatshme të lëshojë urdhër për përcaktimin e afateve konkrete për periudhën paraprake të mbetur. Bazuar në kompetencat e përcaktuara në nenin 39(3) dhe (13) të Ligjit dhe rregullën 95 të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake do të ndërmarrë hapa për të garantuar të drejtat e të akuzuarve për t'u gjykuar brenda një kohe të arsyeshme, siç parashihet nga neni 21(4)(d) i Ligjit.

23. Së pari, Gjykatësi i Procedurës Paraprake e urdhëron ZPS-në të dorëzojë çdo kërkesë që mbetet pa u dorëzuar lidhur me procesin e nxjerrjes së materialit jo më

vonë se të premtën, 5 prill 2024. Gjykatësi i Procedurës Paraprake urdhëron edhe Ekipet e Mbrojtjes të dorëzojnë çdo kërkesë të tillë, veçanërisht për aspektet që kanë identifikuar në lidhje me nxjerrjen e materialit sipas rregullës 102(3) dhe çdo kundërshtim sipas rregullës 95(2)(e) të Rregullores, jo më vonë se të premtën, 19 prill 2024.

24. Së dyti, Gjykatësi i Procedurës Paraprake e urdhëron ZPS-në të dorëzojë një përshkrim të hollësishëm të datës kur mendon t'i përfundojë hetimet e veta jo më vonë se të premtën, 12 prill 2024.

25. Së treti, Gjykatësi i Procedurës Paraprake e urdhëron ZPS-në të përmbushë të gjitha detyrimet paraprake për nxjerrjen e materialit, me përjashtim të ndonjë materiali për të cilin kërkohet autorizim gjyqësor, jo më vonë se të premtën, 19 prill 2024. Më tej, Gjykatësi i Procedurës Paraprake urdhëron ZPS-në të dorëzojë brenda të njëjtës datë një njoftim si pjesë e dokumentacionit të çështjes gjyqësore ku të paraqitet me hollësi i gjithë procesi i nxjerrjes së materialit deri më të njëjtën datë.

26. Së katërti, Gjykatësi i Procedurës Paraprake urdhëron palët t'i përfundojnë diskutimet *inter partes* dhe t'i dorëzojnë pikat e pajtimit mbi aspekte juridike dhe faktike, me anë të një parashtrimi të protokolluar të përbashkët si pjesë e dokumentacionit të çështjes gjyqësore, jo më vonë se të premtën, 17 maj 2024.

27. Së pesti, Gjykatësi i Procedurës Paraprake i urdhëron Ekipet e Mbrojtjes të dorëzojnë dosje paraprake, nëse dëshirojnë, jo më vonë se të premtën, 7 qershor 2024.

28. Së gjashti, Gjykatësi i Procedurës Paraprake urdhëron Ekipet e Mbrojtjes të dorëzojnë kërkesa me shkrim për arsyetimin e ndryshimit të afateve në rast se nuk do të jenë në gjendje të respektojnë kalendarin e punës që përmban ky vendim.

29. Në fund, Gjykatësi i Procedurës Paraprake cakton të premtën, 21 qershor 2024, si datë për kalimin e dokumentacionit të çështjes gjyqësore te Trupi Gjykues,

sipas rregullës 72 të Rregullores lidhur me procedimin e përshpejtuar. Çdo kërkesë për shtyrje afati duhet të arsyetohet prej rrethanave bindëse të paraqitura në parashtrime me shkrim.

IV. VENDIM

30. Gjykatësi i Procedurës Paraprake:

- a) **URDHËRON** Mbrojtjen që, në rast se synon të kërkojë ndihmë juridike, të plotësojë dhe dorëzojë formularët e kërkuar, bashkë me dokumentacionin mbështetës, dhe ta informojë Gjykatësin e Procedurës Paraprake deri **të premtën, 12 prill 2024;**
- b) **URDHËRON** Mbrojtjen që, nëse përballet me pengesa për plotësimin e formularëve të kërkuar ose dokumentacionit mbështetës brenda afateve të përcaktuara, t'i dorëzojë menjëherë parashtrime me shkrim Gjykatësit të Procedurës Paraprake, ku të tregojë arsyet përse nuk mund të plotësohen formularët në tërësi ose pjesë specifike të tyre;
- c) **I KËRKON** Zyrës Administrative t'i shqyrtojë kërkesat për ndihmë juridike urgjentisht;
- d) **UDHËZON** Mbrojtjen që, po ta shohë të nevojshme, të dorëzojë kërkesë me shkrim *ex parte* për vlerësimin mjekësor të të akuzuarit nga një ekspert, në pajtim me paragrafin 18;
- e) **URDHËRON** ZPS-në të dorëzojë çdo kërkesë të mbetur lidhur me procesin e nxjerrjes së materialit deri **të premtën, 5 prill 2024;** dhe urdhëron Mbrojtjen të dorëzojë çdo kërkesë në lidhje me to deri **të premtën, 19 prill 2024;**

- f) **URDHËRON** ZPS-në të dorëzojë një përshkrim të hollësishëm të datës kur mendon t'i përfundojë hetimet e veta deri **të premten, 12 prill 2024;**
- g) **URDHËRON** ZPS-në të përmbushë të gjitha detyrimet paraprake për nxjerrjen e materialit, me përjashtim të materialit për të cilin kërkohet autorizim gjyqësor, dhe të dorëzojë një njoftim si pjesë e dokumentacionit të çështjes gjyqësore ku të paraqitet me hollësi i gjithë procesi i nxjerrjes së materialit, deri **të premten, 19 prill 2024;**
- h) **URDHËRON** palët që t'i përfundojnë diskutimet *inter partes* dhe t'i dorëzojnë pikat e pajtimit mbi aspekte juridike dhe faktike në një parashtrim të protokolluar të përbashkët si pjesë e dokumentacionit të çështjes gjyqësore deri **të premten, 17 maj 2024;** dhe
- i) **URDHËRON** Mbrojtjen të dorëzojë dosje paraprake, nëse dëshiron, deri **të premten, 7 qershor 2024;**
- j) **URDHËRON** Mbrojtjen të dorëzojë kërkesa me shkrim për arsyetimin e ndryshimit të afateve në rast se nuk do të jetë në gjendje të respektojë kalendarin e punës që përmban ky vendim; dhe
- k) **VENDOS** të caktojë **të premten, 21 qershor 2024**, si datë për kalimin e dokumentacionit të çështjes gjyqësore te Trupi Gjykues.

/nënshkrimi/

Gjykatës Nikola Giju

Gjykatës i Procedurës Paraprake

E mërkurë, 27 mars 2024

Hagë, Holandë.